



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 2 , Datë 6.06.2012

Për

Miratimin e projekt-idesë të "Projekti Hidroenergjitik mbi lumin Devoll".

Në zbatim të pikës dh. neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 16.05.2012, mori në shqyrtim projekt-idenë për "Projektin hidroenergjitik të Devollit", i hartuar nga firma projektuese "Devoll Hydropower" ku bëjnë pjesë digat e Banjës, Kokel dhe Moglicë për këtë objekt. Projekt-ideja për "Projektin hidroenergjitik mbi lumun Devoll", u paraqit nga firma projektuese "Devoll Hydropower".

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi diskutoi Projekt-idenë e Skemës së lumit Devoll" dhe të digave Banjë, Kokel, Moglicë :

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë për digat Banjë, Kokel, Moglic, duke sugjeruar :

Plotësimin e kërkesave të shprehura në Vendimin nr.1 datë 22.05.2012 të shkresës, nr.10 prot. datë 22.05.2012 për digat Banjë, Kokel, Moglicë të Skemës së lumit Devoll

Me respekt,

KRYETAR
PERI DISHNICA

